



KOMPANIA UJESJELLËRI RAJONAL SH.A
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOVOSKRUVANJE D.O.O
PRISHTINA

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE E BASHKËPISHTETIMIT: DATE OF JOINT AUDITING:			17.09.2020
1. Kodi i Org. Org. Jedin Org. Unit	2. Shifri i Klasifikimit Klasif. Kod Class. Code	3. Nr. Protokollit Dr. Prot. Prot. No.	4. Nr. i Raportit Bn. Struktura No. Report
05	47	1669	29

Për : Zyren Kombëtare të Auditimit

Për : Kuvendi / KMFP

Nga : Labinot Dedushi – Kryesues i Bordit të Drejtorëve,
Sokol Xhafa- Ud Kryeshef Ekzekutiv

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Të dhëna në raportin e Auditimit nga ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

Prishtinë: Shtator 2020

Rruga Hazir Shala p.n., Prishtinë
Tel + 383 38 54 12 11, +383 38 55 10 10
Fax + 383 38 54 14 37

www.kru-prishtina.com
E-mail: info@kru-prishtina.com



Për Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: KRU Prishtina sh.a – Labinot Dedushi – Kryesues i BpD

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE**
të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e
Auditimit

Nr.	Komponenti e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Komisionet	Veprimet që do të ndermerren dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin të rekomandimit	Zyrtaret pergjegjes	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Baza për opinion	<p>Sipas SNK 16 – Asetet e paluajtshme, pas njohjes si një aktiv, një zë i aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) vlera e drejtë e të cilëve matet me besueshmëri do të bartet me shumën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim i mëpashëm i akumuluar dhe ndonjë humbje e akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja kreditohet drejtpërdrejt tek kapitalët e veta me titullin mbivlerë (tepricë) rivlerësimi. Megjithatë, rritja njihet në fitim ose humbje për aq sa kjo mbulon uljen e rivlerësimit të të njëjtit aktiv të njohur më parë në fitim ose humbje.</p> <p>KRU Prishtina kishte angazhuar një Kompani vlerësuese për rivlerësimin e asetëve dhe më 30.09.2019 kishte pranuar raportin përfundimtar të rivlerësimit. Bazuar në përmbajtjen e këtij raporti</p>		Dardane Sadiku Hazbije Abazi Ardiana Gashi Rilind Beqaj	KRU Prishtina ka angazhuar ekipe të evidentimit të të gjitha asetëve dhe në baze të listës së asetëve nga lista para rivlerësimit, raporti i rivlerësimit dhe lista e asetëve të cilat do të evidentohen nga komisionet atëherë do të behet harmonizimi në mes tri listave dhe në baze të informacioneve të siguruar do të	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 dhe tutje në vitin në vijim	

	<p>dhe bazuar në vlerësimet tona nga analizimi dhe krahasimi i tij me regjistrin e aseteve dhe shumat e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar, janë identifikuar çështjet si në vijim: - Sipas raportit të rivlerësimit të aseteve, Kompania posedon 9,848 asete në vlerë 110,383,453€, përderisa në regjistrin e aseteve të Kompanisë figurojnë 7,601 asete me vlerë 89,725,333€; - Sipas raportit të rivlerësimit të aseteve, në regjistrin e aseteve të Kompanisë figurojnë 1,267 asete me vlerë 7,721,197€ të cilat nuk ekzistojnë fizikisht; - Sipas raportit të rivlerësimit të aseteve, 1,374 asete me vlerë 11,220,632€ të identifikua si të reja, nuk kishin qenë të përfshira në regjistrin e aseteve të Kompanisë; - Sipas raportit të rivlerësimit të aseteve, 642 asete me vlerë neto në libra zero, të cilat janë jashtë funksionit, figurojnë në regjistrin e aseteve të Kompanisë; - Në regjistrin e aseteve figurojnë ende 73 asete me vlerë neto në libra 1,1010,564€, të cilat ishin vlerësuar nga rivlerësuesi me vlerë 0; Marrë parasysh çështjet e identifikua me lartë, Kompania nuk kishte krijuar një regjistër të aseteve në të cilin është e mundur të identifikohet vlera neto në libra në datën e rivlerësimit të aseteve dhe vlera e tyre pas rivlerësimit. Për më tepër, në pasqyra financiare ishte prezantuar vlera e aseteve sipas regjistrit para rivlerësimit dhe teprica e rivlerësimit. Tutje, në pasqyrën e pozitës financiare ishte prezantuar rezerva e rivlerësimit, në vlerë 18,938,574€. Si rrjedhojë e kësaj ishte e pa mundur të vërtetohej saktësia, plotësia e aseteve si dhe cilat asete kanë pësuar rënie/ rritje nga rivlerësimi dhe rrjedhimisht saktësia e rezervës së rivlerësimit. Bazuar në konfirmimet zyrtare, raporti i rivlerësimit ka krijuar paqartësi lidhur me asetet të cilat nuk ekzistojnë dhe atyre të cilat janë identifikuar si të reja, dhe Kompania vlerëson se procesi i rivlerësimit ishte me mangësi të cilat ishin identifikuar gjatë vizitave në teren nga komisioni për pranimin e shërbimeve dhe menaxheri i projektit. Një pjesë të pasurisë të cilat i kishin të regjistruara në modulin e aseteve, rivlerësuesi nuk i ka gjetur fare. Ndërsa në anën tjetër ka listuar shumë asete të reja të cilat sipas menaxhmentit të Kompanisë dyshojnë se ka dyfishim të emërtimeve nga ato të pa gjetura në</p>			<p>behet veprimi kontabël. Ne koordinim me bordin e drejtoresve do të merren masat e duhura konform dokumenteve të siguruara.</p>			
--	--	--	--	---	--	--	--

		<p>raport. Si rezultat i kësaj, ishte shumë i vështirë kalkulimi dhe implementimi i këtij projekti në regjistra dhe pasqyra financiare. Për shkak të kësaj situatë, në raportin e komisionit për pranim të shërbimeve dhe në konfirmimin nga kontraktuesi përmes emailit, mbetet që gjatë periudhës garantuese të defekteve në kohëzgjatje prej 12 muajsh, kontraktuesi të zgjidhë çdo problem që ka pasuar gjatë implementimit të raportit të rivlerësimit.</p> <p>Ndërsa sa i përket aseteve jashtë përdorimit, ato për vite me radhë figurojnë në regjistrë përkundër faktit që komisionet e vlerësimeve ndër vite disa prej tyre i kanë identifikuar si të tilla.</p>					
2	Baza për opinion	<p>Sipas SNK 16 – Asetet e paluajtshme, pika 40, nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi ulet si rezultat i një rivlerësimi, ulja njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, ulja debitohet drejtpërdrejtë tek kapitalet e veta me titullin mbivlera (tepricë) rivlerësimi për aq sa ajo mbulon çdo tepricë kreditore tek mbivlera (teprica) rivlerësimi në lidhje me atë aktiv (nëse ekziston). Bazuar në raportin e rivlerësimit, gjashtë asete të cilat i përkasin kategorisë së tokës kishin pësuar rënie në vlerë prej 2,652,600€. Megjithatë, Kompania këtë rënie të vlerës nuk e kishte njohur si humbje në pasqyrën e të ardhurave por, e kishte përfshirë tek pjesa të ardhurat gjithëpërfshirëse e pasqyrës së të ardhurave në vlerën totale të rezervës së rivlerësimit 18,938,573€, si thyerje e rritjes/rënies së vlerës së aseteve nga rivlerësimi i të gjitha aseteve. Mos regjistrimi i saktë i rënies së vlerës së tokës, ka efekt në nënvlerësimin e ekuitetit të kompanisë dhe në prezantimin jo të saktë të pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse.</p>		Dardane Sadiku Hazbije Abazi Ardiana Gashi Rilind Beqaj	KRU Prishtina ka angazhuar ekupe të evidentimit të të gjitha aseteve dhe në baze të listës së aseteve nga lista para rivlerësimit, raporti i rivlerësimit dhe lista e aseteve të cilat do të evidentohen nga komisionet atëherë do të behet harmonizimi në mes tri listave dhe në baze të informacioneve të siguruar do të behet veprimi kontabël. Në koordinim me bordin e drejtoreshave do të merren masat e duhura konform dokumenteve të siguruar.	Bordi i Drejtoreshave Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 dhe tutje në vitin në vijim

3	Baza për opinion	<p>Sipas SNK 16 – Asetet e paluajtshme, pas njohjes si një aktiv, një zë i aktiveve afatgjata materiale vlera e drejtë e të cilëve matet me besueshmëri do të bartet me shumën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim i mëpasshëm i akumuluar dhe ndonjë humbje e akumuluar nga zhvlerësimi. Vlera e tokave e prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare ishte 29,484,686€, shumë kjo e nënvlerësuar për 825,312€. Ky nënvlerësim rrjedhë si pasojë e mos prezantimit të vlerës së tyre sipas raportit të rivlerësimit të aseteve në të cilin tokat kishin vlerë 30,310,000€. Bazuar në konfirmimet zyrtare, për shkak se raporti i rivlerësimit ishte pranuar në shtator dhe për shkak të numrit të madh të aseteve, kanë ndodhur gabimet e mos prezantimit të saktë të tokave në pasqyra financiare.</p>		Dardane Sadiku Hazbije Abazi Ardiana Gashi Rilind Beqaj				
4	Baza për opinion	<p>Sipas SNK 16 – Asetet e paluajtshme, pika 50, shuma e amortizueshme e një aktivi do të shpërndahet mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Ndërsa në pikën 55 të këtij standardi, jepen shpjegime se amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, d.m.th. kur ai është në vendin dhe kushtet e nevojshme për të, që të ketë mundësi të funksionojë në mënyrën e synuar nga menaxhmenti. Kompania nuk kishte zbatuar kërkesat e standardeve për zhvlerësim të aseteve që nga momenti kur aset i ishte në përdorim, mirëpo zhvlerësimi i tyre ishte bërë në bazë të kërkesave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) të bazuara në UA nr. 02/2016 për zbatimin e ligjit nr. 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e Korporatave, neni 17 pika 5.2 dhe 5.3.1 . Si rezultat i kësaj, shpenzimet e zhvlerësimit për asetet e regjistruara në vitin 2019 ishin mbivlerësuar për 69,861€. Kjo kishte ndodhur për shkak se ndërmarrja nuk harton pasqyra të veçanta në bazë të kërkesave të ATK-së. Për më tepër, shpenzimet e zhvlerësimit vjetor dhe zhvlerësimit të akumuluar ishin mbivlerësuar për 302,391€, si rrjedhojë se në shpenzimet e zhvlerësimit për vitin 2019, ishin përfshirë edhe shpenzimet e zhvlerësimit të cilat i përkasin periudhës 2014-2018 për projektin “Ndërtimi i sistemit për furnizim me ujë të pijshëm dhe industrial në parkun industrial në Drenas”.</p>		Dardane Sadiku Hazbije Abazi Ardiana Gashi Rilind Beqaj	<p>KRU Prishtina ka angazhuar ekipe të evidentimit të të gjitha aseteve dhe ne baze të listes së aseteve nga lista para rivlerësimit, raporti i rivlerësimit dhe lista e aseteve të cilat do të evidentohen nga komisionet atëherë do të behet harmonizimi ne mes tri listave dhe ne baze të informacioneve të siguruara do të behet veprimi kontabël.</p> <p>Ne koordinim me bordin e drejtoreve do të merren masat e duhura konform dokumenteve të siguruara.</p>	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 dhe tutje ne vitin ne vijim	

5	Baza për opinion	<p>Neni 7 i Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (nr. 04/L-014), Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmime mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi i pasurive dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi drejtues i shoqërive tregtare dhe duhet të barazohet me librat kontabël. Komisioni për regjistrim të aseteve, me datë 14.02.2020 kishte dorëzuar raportin përfundimtar të regjistrimit të aseteve. Megjithatë, nuk ishte bërë harmonizimi në mes të regjistrimit të aseteve dhe raportit të komisionit për inventarizim. Kjo kishte ndodhur për shkak, se në raportin e komisionit për inventarizim nuk ishin regjistruar të gjitha asetet por vetëm gjendja e aseteve jashtë përdorimit. Kështu që, ne e kishim të pamundur krahasimin e regjistrimit të aseteve me raportin e inventarizimit të aseteve. Bazuar në konfirmimet zyrtare, raporti i inventarizimit nuk është i plotë për shkak që raporti i rivlerësimit ka identifikuar asete që nuk ekzistojnë edhe asete të reja, për të cilat janë formuar komisione të veçanta të cilat janë në proces për verifikimin e gjendjes së tyre. Mos harmonizimi i gjendjes faktike të aseteve me regjistrat kontabël ka rezultuar me prezantime dhe shpalesje jo të duhura të aseteve në pasqyra financiare.</p>		Dardane Sadiku Hazbiye Abazi Ardiana Gashi Rilind Beqaj	<p>KRU Prishtina ka angazhuar ekipe te evidentimit te te gjitha aseteve dhe ne baze te listes se aseteve nga lista para rivlerësimit, raporti i rivlerësimit dhe lista e aseteve te cilat do te evidentohen nga komisionet atëherë do te behet harmonizimi ne mes tri listave dhe ne baze te informacioneve te siguruara do te behet veprimi kontabël. Ne koordinim me bordin e drejtoreve do te merren masat e duhura konform dokumenteve te siguruara.</p>	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 dhe tutje ne vitin ne vijim	
6	Baza për Opinion	<p>Korniza konceptuale specifikon se në mënyrë që të plotësojnë objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj baze, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen kur ato ndodhin (dhe jo kur mjetet monetare ose ekuivalentët e tyre janë arkëtuar ose paguar) dhe ato regjistrohen në regjistrat kontabël dhe raportohen në pasqyrat financiare të periudhave me të cilat ato lidhen. Zëri kontabël "Investimet në vijim", i prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën 492,261, nuk e prezanton saktë gjendjen e tij. Në kuadër të kësaj shume, është përfshirë shuma prej 347,485€ të cilën Kompania nuk ka arritur ta mbështesë me</p>		Hazbiye Abazi Florida Berisha Yll Shabani	<p>KRU Prishtina ka angazhuar ekipe te evidentimit te te gjitha aseteve dhe ne baze te listes se aseteve nga lista para rivlerësimit, raporti i rivlerësimit dhe lista e aseteve te cilat do te evidentohen nga komisionet atëherë do te behet harmonizimi ne mes tri listave dhe</p>	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 dhe tutje ne vitin ne vijim	

		dëshmi përkatëse. Për më tepër, ishte përfshirë shuma 26,267€, të cilat i takojnë një projekti të përfunduar me date 17.12.2019 dhe të cilat i plotësojnë kriteret e SNK 16, për njohjen e aktiveve afatgjata.2 Bazuar në konfirmimet zyrtare, ndërrimi i menaxhmentit dhe implikimet që kanë rrjedhë nga raporti i rivlerësimit kanë ndikuar që mos të sigurohen informatat e nevojshme lidhur me këtë shumë. Mungesa e dokumenteve mbështetëse vë në dyshim ndodhjen e këtyre aktiviteteve, rrjedhimisht ndikon në mbivlerësimin e investimeve në vijim duke mos paraqitur pamje të vërtetë të pasqyrave financiare.			ne baze te informacioneve te siguruara do te behet veprimi kontabël. Ne koordinim me bordin e drejtoreve do te merren masat e duhura konform dokumenteve te siguruara.			
7	Baza për Opinion	Sipas SNK 1 - Paraqitja e pasqyrave financiare, pasqyra e pozicionit financiar duhet të prezantoj pozicionin financiar në datën e raportimit, duke prezantuar gjendjen e aktiveve, detyrimit si dhe kapitalin neto, mbi bazën e të dhënave kontabël në po të njëjtën datë. Analizat tona tregojnë se llogaritë e arkëtueshme në kontabilitet dhe të prezantuara në pasqyrën e pozitës financiare në krahasim me të dhënat e modulit të shitjes ishin mbivlerësuar për 1,194,622€. Bazuar në konfirmimet zyrtare, diferencat ndërmjet modulit të shitjes dhe vlerave të prezantuara në pasqyra, janë si rezultat i viteve paraprake. Kryesisht dallimet janë në mos harmonizimin e vlerave të borxheve të falura nga sistemi analitik i llogarive të arkëtueshme me shënimet kontabël gjatë periudhës 2015-2017.		Fatmir Murtezi Dardane Sadiku Driton Mulaj	KRU Prishtina do te angazhoje hulumtimin e informacioneve per barazimin e LL/A sa i perket viteve paraprake ndersa ne vitin e fundit po thuajse eshte i harmonizuar ky pozicion. Ne koordinim me bordin e drejtoreve do te merren masat e duhura konform dokumenteve te siguruara.	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 dhe tutje ne vitin ne vijim	
8	Baza për Opinion	Neni 6 (paragrafi 2) i Ligjit Nr. 05/L -043 për Faljen e Borxheve Publike, përcakton se brenda 30 ditësh, nga dita kur një person përmbush njërin nga kriteret e përcaktuara me nenin 43 të këtij ligji, Institucioni Shtetëror përkatës apo Ndërmarrja Publike përkatëse është përgjegjëse për fshirjen e borxheve nga sistemi, duke pasqyruar këto fakte në regjistrat e tyre kontabël. Ndërsa paragrafi 3 i nenit 6 i po të njëjtit ligj, përcakton se nëse personat të cilët përfitojnë nga ky ligj përmes arritjes së marrëveshjes për pagesën me këste të obligimeve për periudhën 1 janar 2009 deri 31 dhjetor 2014, dështojnë në respektimin e kushteve të marrëveshjes, atëherë, Institucioni Shtetëror apo Ndërmarrja Publike ka përgjegjësi që të njëjtin ta		Fatmir Murtezi Driton Mulaj Artan Rexha	Në kuadër të llogarive të arkëtueshme kemi një llogari e veçantë e cila paraqet shumën e borxheve për të cilën konsumatorët kishin aplikuar për përfitimin e faljeve të borxheve. Departamenti i Konsumatorëve, i shitjes dhe zyra ligjore do te e	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 dhe tutje ne vitin ne vijim	

		<p>vendosë në listën e borxheve, duke e bërë obligues për të gjitha borxhet e mbetura sipas kërkesave ligjore që kanë qenë të zbatueshme para lidhjes së marrëveshjes. Në kuadër të llogarive të arkëtueshme ekziston një llogari e veçantë në vlerë 8,648,529€ e cila paraqet shumën e borxheve për të cilën konsumatorët kishin aplikuar për përfitimin e faljeve të borxheve. Bazuar në raportin e konsumatorëve për falje të borxheve, nga gjithsej 51,989 konsumatorë, Kompania gjatë vitit 2019, kishte identifikuar vetëm 1,794 konsumatorë të cilët kishin dështuar në përmbushjen e kushteve dhe borxhin e tyre në vlerë 601,799€ e kishte rikthyer në listën e borxheve që këta konsumatorë detyrohen ta paguajnë, por të njëjtën nuk e kishte larguar nga lista e faljes së borxheve. Për më tepër, Kompania nuk posedon evidencë përmes të cilës mundësohet identifikimi i konsumatorëve të cilët i kanë përmbushur kushtet e marrëveshjes dhe kanë përfituar nga falja e borxheve, si dhe të atyre të cilët kanë dështuar në respektimin e kushteve të marrëveshjes. Si rrjedhojë e mungesës së evidencës llogaria e faljeve të borxheve, nuk ishte zvogëluar që nga krijimi i saj. Kjo ndikon që vlera e llogarive të arkëtueshme të mos prezantojë vlerën e saktë të tyre.</p> <p>Bazuar në konfirmimet zyrtare, shkak i parregullsive tek falja e borxheve, ishte numri i lartë i konsumatorëve që kanë përfituar falje të borxheve dhe se këto rregullime nuk ishte e mundur të përfundohen me kohë.</p>			<p>trajtojnë këto çështje dhe konform ligjeve do të i marrin veprimet e duhura.</p> <p>Ne koordinim me bordin e drejtove do të merren masat e duhura konform dokumenteve të siguruara.</p>			
9	Baza për Opnion	<p>Arkëtimet në shumën prej 691,960€, nuk u janë zbritur konsumatorëve përkatës për obligimet e paguara ndaj ndërmarrjes, por këto mjete ishin regjistruar në zërin kontabël me përshkrimin "Pagesat e dyshimta dhe të jashtëzakonshme". Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, kjo ka ndodhur si pasojë e vështirësive në identifikimin e konsumatorëve me rastin e shkarkimit të pagesave nga llogaria bankare. Sipas tyre, ky është një problem i bartur që nga fillimi i vitit 2003, kur ka filluar të mbahet në analitikë gjendja e konsumatorëve. Megjithatë, Kompania ka krijuar komision të veçantë i cili ka pasur për detyrë evidentimin e pagesave dhe me pas korrigjimin adekuat. Gjatë vitit 2019 si rezultat i</p>		<p>Riton Zeka Kushtrim Zeqiri Samir Hoda</p>	<p>KRUP ka ndërmarrë masat e nevojshme për adresimin e çështjes pas kalimit në pagesat online si dhe ngritjen e komisionit për këtë çështje.</p> <p>Ne koordinim me bordin e drejtove do të merren masat e duhura konform dokumenteve të siguruara.</p>	<p>Bordi i Drejtove Kryesuesi i Bordit</p>	<p>30.12.2020 dhe tutje ne vitin ne vijim</p>	

		punës se komisionit ka pasur përmirësime në vlerën 104,679€.						
10	Baza për Opnion	<p>Seksioni i të arkëtueshmeve përmban zërin kontabël "Kërkesat tjera", në shumën 534,591€. Në kuadër të këtij zëri janë përfshirë lloje të ndryshme të kërkesave ndaj të tretëve për arkëtimet e mjeteve monetare nga ana e Kompanisë, për të cilat janë identifikuar çështjet si në vijim: - Në kuadër të këtij zëri kontabël janë përfshirë: "Paradhëniet" në shumën 7,217€, "Kërkesat tjera" në vlerë 20,597€ dhe "Kërkesat ndaj Granteve" në vlerë 25,407€ për të cilat mungojnë shënimet analitike dhe dëshmitë përkatëse lidhur me përbërjen e tyre; - Në kuadër të zërit "Kërkesat tjera" janë përfshirë "Paradhënie për tatim në ATK" në shumën 57,402€, mirëpo bazuar në "Gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera të tatimpaguesit" dhe nga letër konfirmimi për konfirmim e llogarive tatimore të pranuar nga Administrata Tatimore e Kosovë (tutje ATK), vlera e kësaj llogarie tatimore është zero; - Në kuadër të zërit "Kërkesat tjera" ishin përfshirë 21,510€, të cilat kishin të bëjnë me një kontest gjyqësor me një furnitor. Megjithatë, gjykata kishte vendosur në favor të furnitorit por Kompania nuk kishte bërë veprimet e nevojshme kontabël për këtë rast, duke mbivlerësuar pasuritë tjera. Gabimet gjatë regjistrimeve të disa transaksioneve në vitet paraprake të cilat reflektojnë edhe saldon përfundimtare, sipas zyrtarëve të Kompanisë ishin shkak i parregullsive të identifikuar tek zëri kërkesat tjera. Ndërsa sa i përket kontestit gjyqësor rregullimet nuk ishin bërë për shkak të mungesës së informacionit me kohë.</p>		Hazbije Abazi Florida berisha Trëndelina Aliu	<p>KRUP ka marrë veprimet e duhura për çështjen në fjalë, sa i përket mjeteve për kthim nga Gjykata ndërsa sa i përket kërkesave tjera një pjesë janë trajtuar ndërsa pjesa tjetër varësisht prej sigurimit të dokumentacionit do të bëhen veprimet e nevojshme duke ditur se gjetja nuk ka të bëjë me vitin e fundit.</p> <p>Ne koordinim me bordin e drejtove do të merren masat e duhura konform dokumenteve të siguruara.</p>	Bordi i Drejtove Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 dhe tutje ne vitin ne vijim	

11	Baza për Opinion	<p>Parapagimet janë pagesa të bëra gjatë një periudhe të kontabilitetit, por të cilat nuk duhet t'i ngarkohen fitimit deri në një periudhë të mëvonshme, për arsye se ato kanë të bëjnë me periudhën e mëvonshme në fjalë. Këto klasifikohen si pasuri, sepse ndërmarrja ka kontrollin mbi to dhe pret të marrë prej tyre përfitime nga data e ndërtimit të pasqyrave financiare.</p> <p>Parapagimet ndaj furnitorëve për shërbimet/furnizimet e marra në shumën 23,352€, nuk janë njohur si parapagime – pasuri, por për këtë shumë ishte zvogëluar totali i llogarive të pagueshme. Përveç kësaj, bazuar në letër konfirmimin e pranuar nga Zyra e Tatimit në Pronë në Komunën e Prishtinës, Kompania është në parapagim për tatim në pronë për 135,231€, mirëpo kjo shumë nuk ekziston në shënimet kontabël dhe rrjedhimisht nuk është prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare. Mos regjistrimi i parapagimeve ka ndikuar në nënvlerësimin e të pagueshmeve dhe pasurive.</p>		<p>Hazbije Abazi Florida Berisha Rashit Mehmeti Trëndelina Aliu</p>	<p>KRUP do të ndërmarrë hapat nevojshme për rregullimin e çështjes bazuar në dokumentacionin përkatës për këtë çështje.</p> <p>Ne koordinim me bordin e drejtove do të merren masat e duhura konform dokumenteve të siguruara.</p>	<p>Bordi i Drejtove Kryesuesi i Bordit</p>	<p>30.12.2020 dhe tutje ne vitin ne vijim</p>	
12	Baza për Opinion	<p>Sipas Kornizës Konceptuale (paragrafi 4.46) një detyrim njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur ka gjasa që burime ekonomike do të dalin nga njësia ekonomike për të shlyer një detyrim aktual dhe shuma me të cilën do të shlyhet detyrimi mund të matet me besueshmëri. Llogaritë e pagueshme tregtare të prezantuara në Pasqyrën pozicionit financiar nuk prezantojnë saktë gjendjen e tyre. Në kuadër të tyre, ekzistojnë detyrime ndaj tre furnitorëve në shumën 168,696€ dhe parapagime në vlerë 15,396€ ndaj dy furnitorëve për të cilët Kompania nuk ka arritur ta mbështesë me dëshmi burimore – fatura apo kontrata që e mbështesin detyrimin dhe parapagimin e Kompanisë ndaj furnitorëve. Tutje, bazuar në analizat tona dhe letër konfirmimet e pranuar nga furnitorët, në shtatë raste ekzistojnë mospërputhje në mes shënimeve kontabël dhe shënimeve të furnitorëve. Në pesë raste shuma e detyrimit ishte mbivlerësuar për 19,946€, ndërsa në dy raste tjera detyrimi ishte nënvlerësuar për 44,314€. Bazuar në konfirmimet zyrtare, mungesën e dëshmive Kompania e arsyeton se ato janë borxhe shumë të vjetra (2009). Ndërsa mos përputhjen e detyrimeve me konfirmimet e</p>		<p>Hazbije Abazi Florida Berisha Rilind Beqaj Trëndelina Aliu</p>	<p>Komisioni i angazhuar për këtë gjetje do të bëjë përpjekje të sigurimit të dokumentacionit relevant ndaj tre furnitorët e cekur.</p> <p>Pasi të keni siguruar informatat relevante do të bëhet pasqyrimi i korrektimit në softwer.</p> <p>Ne koordinim me bordin e drejtove do të merren masat e duhura konform dokumenteve të siguruara</p>	<p>Bordi i Drejtove Kryesuesi i Bordit</p>	<p>30.12.2020</p>	

		furnitorëve e arsyetojnë se disa fatura janë pranuar me vonesë.						
13	Baza për Opinion	<p>Seksioni i detyrimeve afatshkurtra përmban edhe zërin kontabël "Tatimet e pagueshme aktuale", në shumën prej 511,613€, në kuadër të cilit janë përfshirë lloje të ndryshme të detyrimeve, për të cilat janë identifikuar parregullsitë si në vijim: - Llogaria "Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH) e pagueshme" është llogari e detyrimeve. Me tepricën kreditore të kësaj llogarie, tregohet detyrimi i papaguar ndaj shtetit për TVSH-në. Në pasqyrën e pozicionit financiar, ajo prezantohet në seksionin e detyrimeve afatshkurtra. Kompania, detyrimet për TVSH i kishte prezantuar në shumën 116,515€. Bazuar në "Gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera të tatimpaguesit", letër konfirmimin e pranuar nga ATK dhe analizat tona të bëra bazuar në Deklaratat tatimore për këtë llogari tatimore, Kompania më 31.12.2019 kishte saldo kreditore ndaj ATK-së për shumën 48,218€ për këtë llogari tatimore. Diferenca ndërmjet shumës së prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare dhe detyrimit të konfirmuar, në shumën prej 68,297€, është shumë për të cilën janë mbivlerësuar detyrimet afatshkurtra.</p> <p>Mbivlerësimi i detyrimeve ka ndodhur si rezultat i llogaritjes së obligimit të muajit nëntor edhe pse ishte paguar në fund të dhjetorit. Kompania nuk ka qenë subjekt i kontrollit nga Administrata Tatimore që nga viti 2011. - Tatimi mbi të ardhurat (fitimin) e biznesit përfaqëson shumat, që i paguajnë në mënyrë të pakthyeshme buxhetit të shtetit njësitë ekonomike, në raport me fitimin apo të ardhurat e realizuara prej tyre. Kompania ka prezantuar detyrimet për Tatimin në Fitim në shumën 94,064€, mirëpo bazuar në "Gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera të tatimpaguesit" dhe nga letër konfirmimi i pranuar nga ATK, detyrimi për këtë llogari tatimore është zero. Diferenca ndërmjet shumës së prezantuar dhe asaj të konfirmuar, është në shumë prej 94,064€, për të cilën janë mbivlerësuar detyrimet afatshkurtra. - Detyrimet ndaj pagave në pasqyrën e pozicionit financiar janë të prezantuara në vlerë prej</p>		Hazbiye Abazi Florida Berisha Rilind Beqaj Trëndelina Aliu	Komisioni i angazhuar për këtë gjetje do të bëjë përpjekje të sigurimit të dokumentacionet në lidhje me detyrimet afatshkurtra. Pasi të keni siguruar informatat relevante do të bëhet pasqyrimi i korrektimit në softwer. Ne koordinim me bordin e drejtoveve do të merren masat e duhura konform dokumenteve të siguruara	Bordi i Drejtoveve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020	

		183,593€, shumë kjo e nënvlerësuar për 19,043€. - Në kuadër të zërit tatimi i pagueshëm, është përfshirë edhe zëri detyrimet tjera ndaj punëtorëve, në shumën 47,608, shumë për të cilën kompania nuk posedon dëshmi përkatëse lidhur me përbërjen e saj. Sipas zyrtarëve të kompanisë, parregullsitë e identifikuar tek zëri tatimi i pagueshëm janë për shkak të disa gabimeve gjatë regjistrimeve të disa transaksioneve në vitet paraprake dhe që kanë të bëjnë me saldo fillestare, të cilat reflektojnë edhe saldon përfundimtare.						
14	Baza për Opinion	Sipas SNK 20, Grantet qeveritare që lidhen me aktivet, njihen fillimisht si të hyra të shtyra (detyrime) dhe një pjesë transferohen në të ardhura çdo vit. Të hyrat shtyra të prezantuara në kuadër të zërit financiar "kreditë dhe huatë" në pasqyrën e pozicionit financiar, nuk prezantojnë saktë gjendjen e tyre. Në shënimet kontabël dhe në pasqyrën e pozicionit financiar ato janë prezantuar në vlerë 31,873,098€. Mirëpo, bazuar në regjistrin e aseteve të financuara nga grantet, vlera neto e këtyre aseteve në fund të vitit 2019 ishte 25,899,765€ apo 5,973,332€ më pak se vlera e prezantuar në pasqyra financiare. Përveç kësaj, nëntë asete të pranuar donacion gjatë periudhës 2012-2016 ishin regjistruar në kuadër të hyrave të shtyra në vlerë 65,643€ sipas vlerës së përcaktuar gjatë rivlerësimit të aseteve. Ndërsa, dy asete të pranuar donacion në vlerë 53,703€ të cilat janë prezantuar në kuadër të zërit financiar "Të mirat e marra gratis", të njëjtat janë prezantuar në kuadër të hyrave të shtyra. Sipas konfirmimeve zyrtare, mangësitë e identifikuar janë si rezultat i gabimeve gjatë regjistrimeve në vitet paraprake.		Hazbije Abazi Florida Berisha Rilind Beqaj Trëndelina Aliu	Komisioni i angazhuar për këtë gjetje do të bëjë përpjekje të sigurimit të dokumentacionit dhe mbi bazën e dokumentacionit do të bëhen korrigjimet e nevojshme sa i përket trajtimit të Granteve Qeveritare. Dhe këto korrigjime do të pasqyrohen në pasqyrat financiare të vitit 2020. Ne koordinim me bordin e drejtoreve do të merren masat e duhura konform dokumenteve të siguruara	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 dhe në varësi prej vështirësive të sigurimit të dokumentacionit do të vazhdojë tutje.	

15	Baza për Opinion	<p>Sipas SNK 8 - Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet, paragrafi 4.1, gabimet materiale ndonjëherë mbeten të pazbuluara deri në periudhat e mëvonshme dhe këto gabime të periudhave paraardhëse korrigjohen në informacionin krahasues të paraqitur në pasqyrat financiare për periudhat e mëvonshme.</p> <p>Mbivlerësimi i të hyrave, të identifikuar në auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018 e që ishte gabim material, nuk ishte korrigjuar me një ri deklaram retrospektiv dhe shpalsje përkatëse me rastin e hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2019, por ishte korrigjuar në vlerën e të hyrave të vitit 2019 duke nën dekluarar të hyrat për 101,692€. Po ashtu, gabimi i identifikuar në auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018 në lidhje me njohjen e "bocave të klorit" si shpenzime përderisa ato plotësonin kriteret për njohje si asete, ishin korrigjuar në vitin 2019 duke i njohur si të hyra në vlerë 35,345€, e jo duke i korrigjuar fitimet e mbajtura. Gabimet e identifikuar në vitin paraprak të cilat ishin korrigjuar në vitin aktual kanë për efekt prezantimin e pa saktë të vlerës së të hyrave dhe rrjedhimit prezantim të pa saktë të rezultatit financiar në vitin aktual.</p>		<p>Hazbije Abazi Yll Shabani Ardiana Gashi</p>	<p>KRUP do të ndërmarrë masat që të sigurohemi se para se ndermirën veprimeve do të konsultohet me Auditorin e Brendshëm por edhe me ZKA. Ne koordinim me bordin e drejtoreve do te merren masat e duhura konform dokumenteve te siguruara</p>	<p>Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit</p>	<p>30.12.2020</p>	
16	Baza për Opinion	<p>Sipas SNK 20 – Grantet qeveritare, grandet e marra për aktive të amortizueshme njihen si të ardhura gjatë periudhave në të cilat ngarkohet amortizimi për ato mjete. Në pasqyrën e të ardhurave, të hyrat nga grandet ishin prezantuar në shumën 2,205,947€, shumë kjo e mbivlerësuar për 302,391. Ky mbivlerësim ishte si rrjedhojë se, Kompania shpenzimet e zhvlerësimit për periudhën 2014-2018, për një aset të financuar nga grantet nuk i kishte njohur në periudhën përkatëse, por të njëjtën shumë e kishte njohur si të hyra nga grantet në vitin 2019.</p>		<p>Hazbije Abazi Yll Shabani Ardiana Gashi</p>	<p>KRUP do të ndërmarrë masat që të sigurohemi se para se ndërmerren veprimeve do të konsultohet me Auditorin e Brendshëm por edhe me ZKA. Ne koordinim me bordin e drejtoreve do te merren masat e duhura konform dokumenteve te siguruara</p>	<p>Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit</p>	<p>30.12.2020</p>	

17	Baza për Opinion	<p>Një borxh i pa arkëtueshëm i cili është shlyer direkt nga librat kontabël mund të ndodhë të arkëtohet papritur. Kur borxhi i fshirë si i pa-arkëtueshëm në njëri periudhë të kontabilitetit arkëtohet në një periudhë me vonë të kontabilitetit, shuma e arkëtuar duhet të regjistrohet si e ardhur shtesë në pasqyrën e të ardhurave në të cilën është arkëtuar pagesa. Kompania në vitin 2019 kishte njohur të hyra në vlerë 647,691€, në emër të arkëtimit të borxheve të këqija të njohura në vitin 2015. Megjithatë, Kompania nuk ka arritur të na dëshmojë se me të vërtet këto borxhe të arkëtuara nga këta konsumatorë ishin njohur si borxhe të këqija pasi që në vitin 2015 provizionimi nuk ishte bërë specifik po ishte bërë provizionim i përgjithshëm bazuar në një përqindje për të gjitha llogaritë e arkëtueshme.</p>		Fatmir Murtezaj Driton Mulaj Dardane Sadiku	KRUP do të ndër marrë masat që të sigurohemi se para se ndërmerren veprimet do të konsultohet me Auditorin e Brendshëm por edhe me ZKA. Ne koordinim me bordin e drejtoreshave do të merren masat e duhura konform dokumenteve të siguruar	Bordi i Drejtoreshave Kryesuesi i Bordit	30.12.2020	
18	Baza për Opinion	<p>Në memorandumun e bashkëpunimit në mes Bankës KFË dhe Komunës së Prishtinës, për financimin dhe administrimin e projektit "Ujësjellësi Komunal dhe Largimi i Kanalizimit në Prishtinë Faza III" komponenta I, është rënë dakord që fondet prej 5 mil Euro nga Komuna Prishtinë të transferohen në një llogari të veçantë të KRU Prishtina dhe të përdoren ekskluzivisht për projektin e lartpërmendur. Për shkak të pengesave që kanë ndodhur gjatë zbatimit të projektit (Probleme me shpronësime dhe pengesa tjera gjatë ekzekutimit të punimeve), të cilat kanë ndikuar në mos realizimin e projektit sipas planit kohor të paraparë, Kompania ishte detyruar që të paguaj ndëshkime ndaj operatorit ekonomik në vlerë 207,466€. Me qëllim të shlyerjes së këtij obligimi Kompania kishte shfrytëzuar mjetet e mbetura të Komunës së Prishtinës pa ndonjë aprovim paraprak prej saj. Sipas konfirmimeve zyrtare, pagesën e ndëshkimeve Kompania e kishte vlerësuar si pjesë përbërëse të projektit dhe nuk e kishte konsideruar si të nevojshme aprovimin nga komuna për shfrytëzimin e mjeteve të mbetura.</p>			E mbyllur			

19	Baza për Opinion	<p>Sipas SNK 1- Paraqitja e pasqyrave financiare, një njësi ekonomike duhet të përgatisë pasqyrat financiare të saj, me përjashtim të informacionit mbi rrjedhën e parasë, mbi bazën e kontabilitetit rritës. Qëllimi i pasqyrës së rrjedhës së parasë, sipas SNK 7, është për të plotësuar nevojat e përdoruesve të informacionit kontabël në lidhje me rezultatin monetar, me fluksin e lëvizjes së mjeteve monetare gjatë një periudhe kontabël. Kompania kishte hartuar pasqyrën e rrjedhës së parasë, mirëpo tek rrjedha e parave nga aktivitetet investuese, përkatësisht për zërin "Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve" kishte prezantuar shumën 1,721,444€, e cila përbëhet nga blerjet e vitit për investime në vlerë 1,435,793 kurse shtesa në shumën 285,651€ është prezantuar vetëm me qëllim të barazimit të gjendjes së parave në fund me gjendjen e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar. Përveç kësaj, bazuar në çështjet e ngritura për zërat kontabël si, të arkëtueshmet, pagueshmet, parapagimet dhe zhvlerësimi, zëra të aktiviteteve operative të rrjedhës së parasë, vijmë në përfundim se rrjedha e parasë nuk prezanton një informacion të saktë. Sipas konfirmimeve zyrtare, shuma e prezantuar tek zëri "Pagesa për blerje të pronës, pajisjeve dhe impianteve" në Pasqyrën e Rrjedhës së parave, ka ndodhur me qëllim të barazimit të gjendjes së parave në fund me gjendjen e parave të prezantuar në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, ndërkaq mos regjistrimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes ka ndodhur për shkak të pranimit me vonësë të gjendjes së llogarisë nga banka respektive. Mos prezantimi i saktë i pasqyrës së rrjedhës së parave pamundëson prezantimin e saktë të hyrjeve dhe daljeve të parasë.</p>		Dardane Sadiku Florida Berisha Hazbije Abazi	KRUP do të ndërmarrë veprimet e nevojshme gjatë përpilimit të Pasqyrës së Rrjedhës së parasë në mënyrë që prezentimi i zërave të reflektojë drejtë bazuar në sigurimin e informacioneve	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 dhe në varësi prej vështirësive të sigurimit të dokumentacionit do të vazhdojë tutje.	
----	------------------	---	--	--	---	--	--	--

20	Baza për Opinion	Sipas SNK 1 - Paraqitja e pasqyrave financiare, një pako e pasqyrave financiare, duhet të përmbajë edhe një pasqyrë të ndryshimeve në ekuitet, e cila paraqet një përmbledhje të të gjitha ndryshimeve në ekuitet. Çështjet e ngritura brenda këtij kapitulli, në lidhje me rezervën e rivlerësimit dhe të hyrat, të hyrat nga grantet dhe shpenzimet e zhvlerësimit të cilat kanë ndikim në rezultatin financiar në pasqyrën e të ardhurave, kanë efekt gjithashtu edhe në pasqyrim të pasaktë të fitimit të periudhës të bartur në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet.		Dardane Sadiku Rilind Beqaj Hazbije Abazi	KRUP do të ndërmarrë veprimet e nevojshme gjatë përpilimit të Pasqyrës së Rrjedhës së parasë në mënyrë që prezentimi i zërave të reflektojë drejtë bazuar në sigurimin e informacioneve	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 dhe në varësi prej vështirësive të sigurimit të dokumentacionit do të vazhdojë tutje.	
21	Baza për Opinion	Sipas SNK 1 – Paraqitja e pasqyrave financiare, një element i pandarë i pasqyrave financiare janë shënimet shpjeguese të tyre. Sipas përcaktimeve të bëra në këtë standard këto shënime të pasqyrave financiare duhet: të paraqesin informacion në lidhje me bazat e përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare si dhe në lidhje me politikat kontabël të zgjedhura dhe të aplikuara për ngjarjet dhe veprimet më të rëndësishme; sqarojnë informacionin e kërkuar nga SNK; japin informacione shtesë i cili nuk është paraqitur në pasqyrat financiare por i cili është i nevojshëm për një paraqitje të drejtë të tyre. Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare mungonin informata të rëndësishme të cilat janë në kundërshtim me kriteret përkatëse të paraqitura në vijim: - Sipas SNK 1 – Paraqitja e pasqyrave financiare, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Ndërsa SNK 16 – Pasuritë e paluajtshme, specifikon se në pasqyrat financiare duhet të jepen shënimet shpjeguese për çdo kategori të aktiveve afatgjata materiale ndër të tjera për: humbjet nga zhvlerësimi të njohura në fitim ose humbje, shtesat dhe të tjera. Kompania nuk kishte dhënë informacione shpjeguese për kërkesat që dalin nga standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, respektivisht për asetet të cilave i ka rënë vlera bartëse nga vlera e drejtë dhe për investimet në vijim. - Në shënimet shpjeguese zëri kontabël "Tatimet e pagueshme aktuale" në shumën prej 511,613€, janë prezantuar shumat e kontove që përbëjnë këtë zë, mirëpo për		Dardane Sadiku Rilind Beqaj Hazbije Abazi	KRUP do të ndërmarrë veprimet e nevojshme gjatë përpilimit të Pasqyrës së Rrjedhës së parasë në mënyrë që prezentimi i zërave të reflektojë drejtë bazuar në sigurimin e informacioneve	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 dhe në varësi prej vështirësive të sigurimit të dokumentacionit do të vazhdojë tutje.	

	<p>të njëjtat nuk ka detaje për të informuar përdoruesit mbi përbërjen e tyre. Ndër të tjera në këtë zë janë të përfshira Detyrimet tjera të papërcaktuara nga pagat, Detyrimet ndaj tatimit në fitim, Detyrimet e TVSH-së si dhe detyrimet ndaj pagave bruto të cilat nga testimet tona nuk paraqesin vlerën e drejtë, e rrjedhimisht edhe informacioni në shënimet shpjeguese nuk paraqet informacione të sakta.</p> <p>- Sipas SNK 2 - Inventarët, Kompania në pasqyrat e saj, duhet të jep informacione shpjeguese për politikat kontabël të adoptuara për matjen e inventarëve, përfshirë formulën e kostos së përdorur. Sa i përket zërit të stoqeve Kompania kishte perzantuar se përdor metodën e çmimit mesatar, përderisa nga konfirmimet e pranuar si dhe analitikës së njohjes së shpenzimeve me rastin e daljes së stoqeve nga depo, ndërmarrja përdorë metodën FIFO (First In, First Out - "hyrje e parë, dalje e parë"). Mos prezantimi i saktë i metodës së përdorur për njohjen e shpenzimeve me rastin e daljes së stoqeve nga depo, zyrtarët e kanë cilësuar si gabim teknik. - Sipas SNK 20 - Grantet qeveritare, duhet të jepen informacione shpjeguese për politikat kontabël të përdorura për grantet, natyrën dhe madhësinë e granteve qeveritare të njohura në pasqyrat financiare, dhe kushtet e paplotësuara të lidhura me ndihmën qeveritare. Kompania kishte shpalosur kushtet e pa plotësuara për grandet dhe nuk ishte dhënë asnjë informacion specifik në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen. - Sipas SNK 7 - Pasqyra e rrjedhës së parasë, paragrafi 50, specifikon se në informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare duhet të prezantohet edhe shuma e huave të pa tërhequra që mund të jetë e disponueshme për veprimtari të shfrytëzimit në të ardhmen. Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, Kompania nuk ka prezantuar informacione për të njoftuar përdoruesit e tyre lidhur me linjën kreditore të lejuar aktive në vlerë prej 5,000€. Mos prezantimi i linjës kreditore nga zyrtarët e ndërmarrjes është arsyetuar se një gjë tilla nuk është bërë për faktin se mjetet nuk janë shfrytëzuar asnjëherë. - Në shënimet shpjeguese është prezantuar se me 31.12.2019 kishte 579 të</p>						
--	--	--	--	--	--	--	--

		<p>punësuar aktiv me kontratë të rregulltë pune , përderisa numri total i punëtorëve aktiv është 587 punonjës (581 punëtorë me kontratë të rregulltë pune si dhe 6 me kontratë për punë dhe detyra specifike). - Përveç kësaj, si rrjedhojë e mangësive të cilat janë identifikuar dhe prezantuar tek baza për opinion, për zërat: llogaritë e arkëtueshme, kërkesat tjera, tatimi i pagueshëm, llogaritë e pagueshme, parapagimet paraqiten mangësi edhe në shënimet shpjeguese të cilat nuk japin informacione të plota dhe të sakta.</p>						
22	Mos prezantim i saktë i të hyrave të shtyra	<p>Sipas SNK 1, pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas parimit akrual. Sipas këtij parimi, të hyrat e shtyra janë të hyra të arkëtuara në avancë, dhe paraqesin detyrime që ka ndërmarrja për të kryer shërbime në të ardhmen, për shkak të shumave monetare të arkëtuara paraprakisht prej ndërmarrjes. Kështu që, në momentin e marrjes së këtyre mjeteve monetare, duke zbatuar parimin e përputhjes së të ardhurave me shpenzimet e kryera për to, ndërmarrja nuk i njeh këto arkëtime si të hyra, pasi shpenzimet për to ende nuk janë kryer. Pra, shtynë njohjen e këtyre të hyrave dhe si pasojë ato do të njihen si detyrime.</p> <p>Gjetja: Kompania, arkëtimet në avancë nga klientët e saj (që kishin parapaguar për shërbimet e ujit në të ardhmen) në shumën 35,065€, nuk i ka njohur si të hyra të shtyra - detyrime, por për këtë shumë kishte zvogëluar totalin e llogarive të arkëtueshme. Përveç kësaj, të hyrat e shtyra të prezantuara në pasqyrën e pozitës financiare krahasuar me shënimet analitike ishin mbivlerësuar për 13,616€. Veprimet e tilla kanë ndodhur për shkak të pakujdesisë për trajtimin e çështjeve në përputhje me standardet e kontabilitetit.</p> <p>Ndikimi: Mos prezantimi i të hyrave të shtyra ka ndikuar në nënvlerësimin e të arkëtueshmeve dhe të detyrimeve - të hyrave të shtyra për këtë shumë. Ndërsa diferencat në mes të shënimeve analitike dhe pasqyrave financiare ndikojnë në mos prezantimin e saktë të tyre.</p>	<p>Bordi i drejtorëve të sigurojë, që zyrtarët financiar, regjistrimin e veprimeve që japin efekt në disa periudha kontabël, ta bëjnë duke u bazuar në parimin akrual duke siguruar që të hyrat e shtyra ekonomikisht maturohen (realizohen) edhe në periudhat e ardhshme kontabël. Tutje, të merren veprimet e nevojshme korrigjuese në mënyrë që vlera e prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare të jetë e saktë.</p>	<p>Aziz Jashari Yll Shabani Hazbije Abazi</p>	<p>KRUP do të sigurojë, që zyrtarët financiar, regjistrimin e veprimeve që japin efekt në disa periudha kontabël, ta bëjnë duke u bazuar në parimin akrual duke siguruar që të hyrat e shtyra ekonomikisht maturohen (realizohen) edhe në periudhat e ardhshme kontabël. Tutje, të merren veprimet e nevojshme korrigjuese në mënyrë që vlera e prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare të jetë e saktë.</p>	<p>Bordi i Drejtoreshave Kryesuesi i Bordit</p>	<p>30.12.2020</p>	

23	Mos njohja e te hyrave nga interesi mbi bazën e parimit akrual	<p>Sipas SNK 1, një njësi ekonomike duhet të përgatis pasqyrat e saj financiare me përjashtim të informacionit lidhur me fluksin monetar, duke përdorur kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara apo parimin akrual.</p> <p>Gjetja: Kompania gjatë vitit 2019 kishte katër marrëveshje bankare për depozitimin e mjeteve me afat, nga të cilat pritet që arkëtoj interes në periudhat vijuese me rastin e maturimit. Kompania nuk kishte njohur të hyrat e interesit të fituara (e rrjedhimisht edhe interesin e arkëtueshëm dhe tatimin në interes të pagueshëm për vitin 2019) sipas marrëveshjeve të depozitimit në vlerë prej 41,413€, përderisa për të njëjtat në shënime shpjeguese nuk kishte informacione për ndërprerje eventuale para maturimit.</p> <p>Ndikimi: Mos njohja e të hyrave nga interesi dhe mos njohja e interesit të arkëtueshëm ndikon në nënvlerësimin e të hyrave në pasqyrën e të ardhurave si dhe të arkëtueshmeve në pasqyrën e pozicionit financiar.</p>	Bordi Drejtues të sigurojë, që pasqyrat financiare të përgatiten mbi bazën e parimit akrual duke njohur të hyrat dhe të arkëtueshmet në momentin e ndodhjes.	Dardane Sadiku Riton Zeqka Rilind Beqaj	KRUP do të sigurojë se të hyrat dhe të arkëtushmet do të përgatiten në bazë të parimit akrual.	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020	
----	--	---	--	---	--	--	------------	--

24	Vonesa në regjistrimin e ujëmatësve të konsumatorëve individual	<p>Rregullorja nr. 02/2017 për Procedurat e Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbimet e Ujit, në nenet 12-14 përcakton procesin dhe afatet kohore në bazë të të cilave duhet të bëhet procedimi i aplikacioneve të konsumatorëve për lidhje në rrjetin e ujit dhe regjistrimin e tyre në sistemin e faturimit. Procedura për lidhjen e të aplikuarve në rrjetin e ujit dhe kanalizimit duhet të përfundojë brenda 15 ditëve kalendarike.</p> <p>Gjetja: Nga shtatë mostra të testuara kemi vërejtur se në gjashtë raste procedurat e legalizimit ishin vonuar dhe variojnë nga 2 deri në 10 muaj. Numri i madh i aplikantëve dhe mos përmirësimi i gjendjes nga vet investitorët pas vërejtjeve të pranuar nga komisioni i verifikimit, ishte shkak kryesor për vonesat në verifikim dhe regjistrim të konsumatorëve.</p> <p>Ndikimi Vonesat në procesin e legalizimit apo regjistrimit të këtyre konsumatorëve përveç që janë në kundërshtim me rregulloren për Lidhjen e Konsumatorëve në Shërbimet e Ujit, ndikojnë në mos faturim të të hyrave në periudhën kur ofrohet shërbimi, rritjen e humbjeve të ujit dhe rrjedhimisht edhe në rezultatin financiar të Kompanisë.</p>	Bordi i Drejtoreve të sigurojë se respektohen afatet kohore për lidhjen e aplikantëve në rrjetin e ujit dhe kanalizimit në mënyrë që klientët të marrin shërbimet që ju takojnë në afat kohor optimal dhe të evitohen dëmtimet financiare të Kompanisë.	Arben Hajrizi Fatmir Murtezi Kushtrim Zeqiri Driton Mulaj	KRUP do të sigurojë se regjistrimi i konsumatorëve të përshpejtohet dhe mos të paraqiten vonesa në të ardhmen.	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020	
25	Regjistrimi i konsumatorëve pa i përbushur kriteret e përcaktuara me rregullore	<p>Sipas Rregullores për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit të aprovuar nga ARRUG, parashihet që konsumatorët duhet të përcaktojnë një lokacion të përshtatshëm për vendosjen e ujëmatësve dhe në rast të mos plotësimit të kësaj kërkesë, ofruesi i shërbimit mund të refuzoj ofrimin e shërbimeve ose të suspendoj shërbimet për këta konsumatorë.</p> <p>Gjetja: Gjatë vitit 2019, kërkesë për legalizim të ujëmatësve individual kishin paraqitur 60 investitor të banimeve kolektive. Gjatë trajtimit të kësaj çështje, kemi vërejtur që Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë (tutje KE), me datë 29.11.2019 kishte kërkuar që të regjistrohen të gjithë konsumatorët që janë të pajisur me ujëmatës individual, të cilët kanë aplikuar përmes investitorëve në objekte kolektive. Nga gjithsej 30 objekte kolektive, që legalizohen në bazë të këtij vendimi, ne kemi trajtuar katërraste.</p>	Bordi i Drejtoreve të sigurojë, formimin e një komisioni përkatës për verifikimin e të gjithë konsumatorëve të rinj të regjistruar, për të konfirmuar nëse këta konsumatorë kanë zbatuar vërejtjet e komisionit. Në rastet kur nuk ka ujëmatës kryesor dhe pusetat nuk i plotësojnë standardet e kërkuara, brenda	Arben Hajrizi Fatmir Murtezi Driton Mulaj Kushtrim Zeqiri	KRUP do të sigurojë se regjistrimi i konsumatorëve do të bëhet konform rregulloreve. Për një gjë të tillë tanimë nuk kemi vonesa	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 në vazhdimësi	

		<p>Gjatë shqyrtimit të vërejtjeve të dërguara këtyre investitorëve nga komisioni për verifikim, kemi vërejtur që në tri raste objektet nuk kishin fare puseta me ujëmatës kryesor, ndërsa në një rast ishte vendosur vetëm një ujëmatës kryesor për tërë kompleksin. Pavarësisht kësaj ishin regjistruar 328 konsumatorë, që janë pjesë e këtyre objekteve kolektive. Sipas ish - KE, regjistrimi i këtyre konsumatorëve individual pavarësisht që investitorët nuk i kishin plotësuar të gjitha kriteret (që sipas KE-së i përkisnin fushës teknike-matjet gjeodezike), ishte bërë me qëllim të mënjanim të vonesave në faturimin e të hyrave për shërbimin e ofruar dhe të mos grumbullimit të mëtejshëm të borxheve për konsumatorët.</p> <p>Ndikimi: Legalizimi i konsumatorëve pa i plotësuar të gjitha kriteret, mund të ketë për pasojë keqpërdorimin e ujit nga investitorët dhe konsumatorët duke pasur ndikim në mos faturim të konsumatorëve për shërbimet e ofruara, rrjedhimisht edhe në rritjen e humbjeve financiare për Kompaninë.</p>	<p>një afati sa me të shkurtër kohor të bëhet shkyçja e tyre.</p>					
26	<p>Faturimi i konsumatorëve jo në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ARRU</p>	<p>Sipas rregullores nr. 08/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë neni 14 paragrafi 3, ofruesi i shërbimeve në afat kohor prej 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore7 është i obliguar të instaloj ujëmatësin kryesor (të përbashkët) për ndërtesat e banimit kolektiv, konsumatorët e të cilëve nuk kanë ujëmatës individual.</p> <p>Gjetja: Kompania nuk kishte arritur të zbatoj kërkesat ligjore lidhur me faturimin e konsumatorëve individual pa ujëmatës. Si rrjedhojë, më 06.02.2019 ARRU kishte dërguar paralajmërim lidhur me moszbatimin e dispozitave ligjore për faturim të konsumatorëve për shërbimet e ofruara. Në rast se Kompania nuk i përgjigjet këtij paralajmërimi në afat prej 60 ditë pune për eliminimin e faturimit pa ujëmatës, ARRU do të merr masa konform ligjit, megjithatë Kompania kishte vazhduar të faturoj konsumatorët pa ujëmatës. Më 20.06.2019 ARRU kishte marrë vendim për shtyrjen</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë, hartimin e një plani veprimi për marrjen e masave të ndërprerjes së faturimit në mënyrë paushalle, duke siguruar mënyrën për instalimin e ujëmatësve tek të gjithë këta konsumatorë, afatet kohore dhe masat ndëshkuese për rastet kur nuk bëhet instalimi i ujëmatësve. Ndërsa në rastet kur konsumatorët janë faturuar jo në</p>	<p>Fatmir Murtezi Aferdita Bejta Driton Mulaj Kushtrim Zeqiri</p>	<p>KRUP ka ndërmarrë masa për vendosjen e orëve për të gjithë konsumatorët në mënyrë që të bëhet zbatimi i paushallit. Faturim Paushall në KRUP është i eliminuar.</p>	<p>Bordi i Drejtorëve Kryesuesi i Bordit</p>	<p>30.12.2020 në vazhdimësi</p>	

	<p>(vazhdimin) e afatit deri me 31.10.2019 për eliminimin e faturimit për shërbimet e ujit pa ujëmatës. Po ashtu, me këtë vendim obligohet Kompania që faturimi i konsumatorëve të kategorisë amvisëri në ndërtesat e banimit kolektiv të cilët janë duke u faturuar pa matje, deri në vendosjen e ujëmatësit të përbashkët dhe rregullimin e faturimit (deri me 31.10.2019) për shërbime të ujit të faturohen vetëm me tarifë fikse. Deri në nëntor të vitit 2019 Kompania kishte 1,504 konsumator të cilët nuk kishin të instaluar ujëmatës dhe faturimi i tyre ishte bërë pa matje. Prej tyre, 299 konsumator janë faturuar me ngarkesën 19m³, ndërsa 1,205 konsumator me ngarkese 35m³ dhe 38m³, e cila nuk ishte e aprovuar nga ARRUB. Nga muaji qershor deri nëntor ishin faturuar këta konsumator edhe pse sipas vendimit të ARRU-së këta konsumator do të duhej të faturohen vetëm me tarifë fikse deri në instalimin e ujëmatësit të përbashkët. Tutje, me datë 06.12.2019 ARRU përsëri kishte vazhduar afatin për eliminimin e faturimit paushall deri me 30.03.2020 dhe në të njëjtën kohë kishte obliguar KRU-në të bëjë kompensimin e plotë të konsumatorëve të faturuar në mënyrë të kundërligjshme në faturimin e radhës. Sipas konfirmimeve zyrtare faturimi i konsumatorëve pa ujëmatës ka qenë i lejuar në vitet paraprake dhe si proces ka vazhduar deri në dhjetor të 2019, mirëpo me një vendim të KE-së është ndërprerë.</p> <p>Ndikimi: Faturimi paushall rrezikon që sasia e konsumuar e ujit të mos jetë e saktë dhe sasia e pa faturuar të reflektoj në rritjen e humbjeve të ujit, e cila ndikon në rezultatin financiar të kompanisë. Po ashtu, moszbatimi i kërkesave ligjore dhe paralajmërimeve nga ARRU rrezikon që Kompania të ndëshkohet me masa sanksionuese administrative në pajtim me Ligjin për Rregullimin e shërbimeve të ujit.</p>	<p>harmoni me kërkesat e ARRU-së të bëjë korrigjimet e nevojshme në faturat e radhës për të njëjtit konsumatorë.</p>					
--	---	--	--	--	--	--	--

	<p>veprime për arkëtimin e borxheve nëpërmjet procedurave të përbarimit. Sipas konfirmimeve zyrtare, Kompania ka aplikuar metoda të ndryshme të vërejtjeve, duke dërguar vërejtje direkt konsumatorëve, mirëpo ka raste që nuk i janë dërguar të gjithëve sepse kriteret e zgjedhura mund të mos jene efektive në momentin e përzgjedhjes. Po ashtu, vërejtje janë bërë përmes kontakteve me telefon edhe përmes mjeteve të informimit publik. Ndërsa procedurat përbarimore nuk janë aplikuar për shkak të mungesës të informacioneve sidomos të numrit personal të konsumatorëve ku pa këto të dhëna zyra përbarimore nuk mund të procedoj lëndën për përbarim.</p> <p>Ndikimi: Mos dërgimi i vërejtjeve ndaj borxhlinjve ndikon në uljen e inkasimit dhe rrjedhimisht kjo ndikon në uljen e likuiditetit të Kompanisë. Po ashtu, mos aplikimi i procedurave përbarimore rrezikon vjetërsimin e borxhit dhe mos arkëtimin e tyre.</p>						
29	<p>Ligji nr. 05/l -042 për rregullimin e shërbimeve të ujit neni 24, përcakton që ofruesi i shërbimeve duhet të lidhë kontratë me secilin konsumator ku përcaktohen kushtet e përgjithshme sipas të cilave do t'u ofrohen shërbime konsumatorëve.</p> <p>Gjetja: Sipas regjistrimit të konsumatorëve, Kompania ofron shërbime për 141,224 konsumator, ndërsa deri në fund të vitit 2019 ka lidhur kontrata vetëm me 25,912 prej tyre. Gjatë vitit 2019, Kompania kishte regjistruar 8,623 konsumator të rinj nga të cilët vetëm 321 konsumator ishin pajisur me kontrata. Shkak për këtë sipas departamentit për konsumator ishte mungesa informacionit me rastin e regjistrimit të këtyre konsumatorëve të rinj nga departamenti i shitjes.</p> <p>Ndikimi: Mungesa e marrëdhënies kontraktuale me konsumatorë për shërbimet e ofruara, përveç që krijon pa pajtueshmëri ligjore, pamundëson aplikimin e masave ligjore ndaj këtyre konsumatorëve në rast mos pagesës së borxhit.</p>		Hidajete Sadiku Gazmend Bytyqi Nexhat Jashari	KRUP do të ndërmerr masat e nevojshme për sigurimin e informacioneve që ndërlidhen me marrëveshje kontraktuale në mes KRUP dhe konsumatorit në mënyrë që të rezultojnë të drejtat në mes të dy palëve.	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 në vazhdimësi	

27	Të dhënat e konsumatorëve jo në përputhje me rregullat e ARRU-së	<p>Rregullorja e ARRU-së nr.03/2016 për kartën e konsumatorit të shërbimeve të ujit në Kosovë, parasheh që regjistri i konsumatorëve ndër të tjera duhet të përmbajë: numrin personal dhe emrin e konsumatorit.</p> <p>Gjetja: Në regjistrin e konsumatorëve ekzistojnë 495 konsumator të cilëve ju mungon numri personal dhe emri i konsumatorit. Këta konsumator janë evidentuar me përshkrimin "NN" dhe shuma që këta konsumatori detyrohen Kompanisë është 148,914€. Sipas zyrtareve të Kompanisë regjistrimi i konsumatorëve me përshkrimin "NN" ka ndodhur kryesisht për shkak të kërkesës së investitorëve të objekteve kolektive për apartamentet e pa shituara, në mënyrë që të mos bëhet ngarkesa me borxh në emër të investitorëve deri në shitjen e tyre. Po ashtu edhe në rastet kur ka mbindërtime të objekteve dhe pronarët nuk ofrojnë të dhëna ndërsa Kompanisë i shkaktojnë shpenzime, bëhen regjistrime të tilla, për të pasur një evidencë sa ma të saktë të faturimit (shpërndarjes së ujit).</p> <p>Ndikimi: Evidentimi i konsumatorëve pa përshkrim të emrit të konsumatorit dhe numrit personal, krijon pa pajtueshmëri ligjore dhe mund të ndikoj në mos arkëtim të mjeteve për shkak të pamundësisë se aplikimit të masave ligjore ndaj këtyre borxhlinjve.</p>	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që brenda një afati të përcaktuar kohor të shqyrtojë dhe të marrë masat përmirësuese, në mënyrë që të gjithë konsumatorët e evidentuar me emërtimin "NN" të regjistrohen në emër të shfrytëzuesve të shërbimit. Për më tepër, të sigurohet që shuma debitorë e evidentuar përcaktohet për secilin prej tyre dhe se po merren masat e nevojshme për arkëtime.	Aziz Jashari Kushtrim Zeqiri Shyqeri Krasniqi Ferdane Sylejmani	KRUP ka ndërmarrë masat si për vitin paraprak poashtu edhe në vazhdim për eliminimin e konsumatorëve NN për të cilën ky numër është i zvogëluar dukshëm përveç rasteve specifike ku nuk mund të sigurohet informacion	Bordi i Drejtorëve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 në vazhdimësi	
28	Mos aplikimi i masave ndëshkuese ndaj konsumatorëve borxhlinj	<p>Rregullorja për procedurat e faturimit për shërbimet e ujit, neni 11.1, përcakton se nëse pagesa nuk bëhet brenda afatit të cekur në faturë, Kompania do të procedoj vërejtjen e 2-të, përmes se cilës obligohet konsumatori që brenda 5 ditëve të punës të bëjë pagesën ose do të pasojë ndërprerja. Pas këtij afati Kompania do të iniciojë procedurën e përmbartimit.</p> <p>Gjetja: Pas analizës së bërë në lidhje me borxhet e konsumatorëve, është vërejtur se për 11,865 konsumator, borxhi i individual i të cilëve në fund të vitit ishte mbi 500€ dhe që nuk kishin kryer asnjë pagesë gjatë vitit, Kompania nuk kishte proceduar vërejtje për mos pagesë të borxhit për këta konsumatorë. Për tepër, për 14,048 konsumator me borxh mbi 1,000€, të cilët nuk kanë kryer asnjë pagesë gjatë vitit, Kompania nuk ka ndërmarrë</p>	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të merren masa ndaj konsumatorëve të cilët nuk i përgjigjen kërkesave për pagesë, të dërgoj vërejtjet dhe në rastet kur konsumatorët nuk i përgjigjen vërejtjeve të aplikohen procedurat përmbartimore.	Aziz Jashari Kushtrim Zeqiri Armend Maka Ferdane Sylejmani	KRUP do të sigurohet që në vazhdimësi të aplikojë rregulloret e ARRU që ndërlidhet me konsumatorët të cilët i detyrohen ndërmarrjes duke dërguar vërejtje, shkyqe nga rrjeti dhe përmbartimet private.	Bordi i Drejtorëve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 në vazhdimësi	

30	Mos përfshirja e shpenzimeve të sigurimit të punëtorëve në të ardhurat bruto	<p>Sipas Ligjit Nr.05/L-028 për tatimin në të ardhura personale, neni 9, në të ardhurat bruto nga pagat përfshihen: bonuset, provizionet, mëditjet dhe format e tjera të kompensimit që një punëdhënës apo ndonjë person tjetër, në emër të punëdhënësit ua paguan punonjësve mbi dhe përtej rrogës.</p> <p>Gjetja: Testet tona tregojnë se, shpenzimet e sigurimit shëndetësor të punonjësve në vlerë prej 25,506€, nuk janë përfshirë në të ardhurat bruto nga pagat e punëtorëve sipas kërkesës së ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale.</p> <p>Ndikimi: Mos përfshirja e shpenzimeve të sigurimit shëndetësor të punëtorëve në të ardhurat bruto me qëllim ndaljes së tatimit në të ardhurat personale, ka ndikuar në mos ndaljen e tatimit si dhe në prezantimin jo të saktë.</p>	Bordi Drejtues të sigurojë, që në të ardhurat personale bruto të përfshihen të gjitha përfitimet e punonjësve sipas kërkesës ligjore në mënyrë që të aplikohet tatimi në vlerën e plotë të ardhurave		KRUP nëse në të ardhmen do të ofrojë sigurim shëndetësorë do të zbatojë rekomandimin e ZKA.	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	E mbyllur	
31	Mangësi në Rregulloren e pagave të punonjësve	<p>Bazuar në ndryshimin dhe plotësimin e rregullores së pagave të punonjësve, të aprovuar nga BD gjatë vitit 2015, pagat e punonjësve janë të përcaktuara në bazë të emrave të punonjësve dhe vlera e pagës në kontratë duhet të përcaktohet bazuar në këtë rregullore.</p> <p>Gjetja: Emrat e 22 të punësuarve pas vitit 2015 të cilët mbajnë pozita të ndryshme, nuk figurojnë në listën e koeficienteve të pagave të Rregullores në fuqi, që duhet të ishte bazë mbështetëse për përcaktimin e pagës. Përveç kësaj, në 14 raste të tjera paga e punëtorëve e përcaktuar në kontratën e punës, dallon nga paga e përcaktuar në rregulloren e pagave të punonjësve, kjo si rezultat i ndryshimit të pozitave të tyre. Mungesa e emrave të punëtorëve në listën e koeficienteve të pagave që është pjesë e rregullores si dhe mos harmonizimi në mes të kontratave dhe rregullores, ka ndodhur për arsye se pagat në rregullore janë përcaktuar me emra të punëtorëve dhe jo me pozita, dhe se marrëdhënia e punës me këta punëtorë ishte lidhur apo ka ndryshuar pas aprovimit të kësaj rregulloreje.</p> <p>Ndikimi: Mos përcaktimi i pagave në rregullore për punëtorët e ri të ndërmarrjes, rrezikon që këta punëtorë të shpërblehen me pagë e cila nuk është</p>	Bordi i Drejtoreve të sigurojë, se është bërë azhurnimi i Rregullores së pagave, e cila do të përcaktojë koeficientet e pagave bazuar në pozitën e punonjësve, konform strukturës organizative të Kompanisë.	Islam caka Mehdi Dervishi Hazbije Abazi	KRUP do të bëjë korrigjimin e pozitave konform departamenteve duke zbatuar koeficientet sipas rregullores së sistematizimit.	Bordi i Drejtoreve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 në vazhdimësi	

		në përputhje me pozitën përkatëse. Ndërsa, përcaktimi i koeficienteve në bazë të emrave të punonjësve dhe jo pozitive të punës shkakton parregullsi gjatë sistemimit të punonjësve në pozita të ndryshme të punës.						
32	Emërimi i Zyrtarit të lartë pa kryer procedurë të rekrutimit	<p>Sipas Ligjit nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike, neni 21, paragrafi 4, për përzgjedhjen e personave për emërim si zyrtarë të NP-së, Bordi i Drejtorëve duhet të kryejë një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese e cila ka për qëllim që të gjitha emërimet të bëhen ekskluzivisht në bazë të meritës.</p> <p>Gjetja: Bordi Drejtues i Kompanisë, kishte emëruar Zëvendës Kryeshefin Ekzekutiv pa kryer procedura të rregullta të rekrutimit. Sipas ish Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, emërimi i Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv, ka rezultuar nga performanca e mirë e treguar gjatë detyrave paraprake që është vlerësuar si bazë e mjaftueshme për emërim.</p> <p>Ndikimi: Emërimi i Zyrtarëve të Kompanisë pa kryer procedurë të hapur të rekrutimit, ndikon në dëmtimin e konkurrencës dhe mund të rezultojë me dështim në arritjen e objektivave të Kompanisë.</p>	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që me rastin e angazhimit të Zyrtareve të Kompanisë, të kryejë procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese, me qëllim të angazhimit të kuadrove adekuatë në bazë të meritës.	Bordi Drejtues		Bordi i Drejtorëve Kryesuesi i Bordit	E mbyllur	
33	Mos testimi me shkrim i kandidatëve gjatë procesit të rekrutimit të punonjësve	Sipas Udhëzimit Administrativ për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, kërkohet që për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik të aplikohet testimi me shkrim i të gjithë kandidatëve të cilët kanë plotësuar kriteret e konkursit të shpallur.	Kryesuesi i Bordit të sigurojë, që me rastin e angazhimit të punonjësve të rinj të aplikohet testimi me shkrim për të gjithë kandidatët, të cilët kanë aplikuar dhe kanë plotësuar kriteret e konkurseve të shpallura.	Islam Caka Avni Kastrati Mehdi Dervishi Istref Asllani	KRUP do të sigurojë që të aplikojë të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi sa i përket procedurave të rekrutimit	Bordi i Drejtorëve Kryesuesi i Bordit	E mbyllur	

33		<p>Gjetja: Me rastin e kryerjes së procedurave të rekrutimit për punë dhe detyra specifike, për pozitën Jurist në Zyrën ligjore, Kompania nuk kishte aplikuar testim me shkrim. Sipas zyrtarëve të Kompanisë, testimi me shkrim është eliminuar, me qëllim të përshpejtimit të procedurave si pasojë e mungesës së stafit për çështje shëndetësore dhe të nevojës për staf shtesë.</p> <p>Rreziku: Anashkalimi i testimit me shkrim gjatë procesit të rekrutimit pamundëson krijimin e konkurrencës së drejtë si dhe përzgjedhjen e personave adekuat për pozitat e shpallura.</p>						
34	<p>Ndalesa nga pagat neto të punëtorëve për shpenzime të ujit pa bazë ligjore</p>	<p>Në kontratat e punonjësve të Kompanisë, në nenin 8 të tyre, përveç kompensimit të pagës nuk specifikohet ndonjë ndalesë tjetër.</p> <p>Gjetja: Testimet tona tregojnë se, në 22 raste në shumën totale 4,190€, Kompania kishte ndalur nga pagat neto të punonjësve nga 20€ në baza mujore, ndalesa këto në emër të obligimeve për shërbimet e ujit, pa ndonjë marrëveshje paraprake që dëshmon se i punësuar është pajtuar me një ndalesë të tillë. Totali i tërheqjeve gjatë tërë vitit 2019 ishte 23,972€. Përveç kësaj, në 16 raste vlera e ndalesës për shërbime të ujit ishte më e lartë se sa vlera e borxhit që këta zyrtarë i detyrohen kompanisë, duke rezultuar në parapagime për shërbime të ujit. Sipas zyrtarëve ndalesa e mjeteve nga pagat e punëtorëve për obligimet e shërbimeve të ujit, ka rezultuar nga një vendim i marrë nga viti 2011 dhe ka vazhduar pa ndërprerje. Megjithatë, Kompania nuk ka arritur të na sigurojë një vendim të tillë.</p> <p>Ndikimi: Tërheqja e pa autorizuar nga pagat neto, ndalesa mbi vlerën e shpenzuar duke krijuar parapagime si dhe mungesa e dëshmive se cilat borxhe janë zvogëluar mund të rezultojë në kontestimin e tërheqjeve nga punëtorët si dhe mbivlerësimin e parapagimeve.</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se ndalesat e tilla në pagat e punonjësve shoqërohen me marrëveshje paraprake midis palëve ku specifikohen obligimet dhe të drejtat e secilës palë në mënyrë që të shmangen kontestet e mundshme gjyqësore të cilat mund ta dëmtojnë financiarisht Kompaninë.</p>	<p>Islam Caka Armend Maka</p>	<p>KRUP do të sigurohet që të aplikojë një formë vendimi për ndalesa të tilla ku palët pajtohen për një veprim të tillë.</p> <p>Ky vendim do të ndërmerret në pajtim me BD.</p>	<p>Bordi i Drejtorëve Kryesuesi i Bordit</p>	<p>30.12.2020</p>	

35	Mungesa e dëshmime për dhënien dhe kthimin e akontacioneve	<p>Sipas rregullores për pagesën e paradhënies nga paga bruto, punëtorët kanë të drejtë të marrjes së paradhënies nga paga, përmes një shkrese të aprovuar nga menaxheri përkatës dhe drejtori për financa dhe administratë, deri në vlerën mesatare të pagës neto në tre muajt e fundit dhe se kthimi duhet të bëhet brenda tre muajve nga data e marrjes.</p> <p>Gjetja: Testimet tona në dy raste tregojnë se, Kompania kishte ndaluar nga pagat neto të punëtorëve mjete në emër të pagesës së akontacioneve, përderisa nuk kishte asnjë dëshmi për marrjen e tyre dhe as për mënyrën e pagesës, pasi që të njëjtat i takojnë periudhës 2014-2017. Sipas evidencave shuma e përgjithshme e akontacioneve e prezantuar në zërin kontabël "Kërkesat e arkëtueshme tjera" është në vlerë prej 86,333€ dhe kthimet në emër të tyre gjatë vitit 2019 ishin 1,100€, përderisa Kompania nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për mënyrën e trajtimit të tyre. Sipas zyrtarëve të kompanisë akontacionet i takojnë periudhave të viteve të kaluara dhe se ndalesat nga pagat janë bërë me qëllim të mbylljes së tyre sa më të shpejtë, ndërsa në vitin aktual është ndaluar dhënia e tyre.</p> <p>Ndikimi: Dhënia dhe marrja e akontacioneve pa dëshmi mbështetëse mund të shkaktoj pamundësinë e kthimit të tyre si dhe krijimin e humbjeve për Kompaninë.</p>	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që përmes akteve të brendshme të ndalojnë shfrytëzimin e mjeteve të institucionit pa dëshmi mbështetëse, si dhe rastet aktuale të konkretizohen me dëshmi të dhënies si dhe mënyrës së kthimit të tyre.	Hazbije Abazi Mehdi Dervishi Nexhat Jashari	Kompania ka siguruar informacionet sa i përket çështjes në fjalë dhe kemi bërë kategorizimin sa i përket akontacioneve, prandaj është çështje për të cilën do të marrim veprim së bashku me BD.	Bordi i Drejtorëve Kryesuesi i Bordit	30.12.2020 në vazhdimësi	
36	Vonesa në realizimin e projekteve kapitale	<p>Marrëveshjet kontraktuale të lidhura midis Kompanisë dhe operatorëve ekonomik për investime kapitale, specifikojnë periudhën e planit dinamik për përfundimin e punëve.</p> <p>Gjetja: Për tri projekte kapitale, vlera totale e tyre ishte 518,294€, kishte vonesa në realizimin e tyre. Tejkalimi i planit dinamik ishte nga 44 ditë - 425 ditë. Sipas zyrtarëve të Kompanisë ndër shkaqet kryesore për këto vonesa ishin: reshjet atmosferike, aprovimet e materialit dhe testimet e rrjetit.</p> <p>Ndikimi: Mos ekzekutimi i kontratave sipas afateve kohore, ndikon potencialisht në hyrje në obligime</p>	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që të ndërmerren veprimet e nevojshme në menaxhimin dhe implementimin e projekteve për investime kapitale, në mënyrë që ekzekutimi i punëve të realizohet brenda	Arben Hajrizi Agim Dema Nexhmije Sadiku	Kompania do të marrë veprimet e nevojshme në mënyrë që vonesa në zbatimin e kontratave mos të ketë në të ardhmen.	Bordi i Drejtorëve Kryesuesi i Bordit	E mbyllur	

		dhe implikime financiare që mund të dalin nga zgjatja e afateve kohore.	afateve të parapara kohore.					
37	Mos përcjellja e implementimit të rekomandimeve nga NJAB	<p>Gjetja: NJAB nuk kishte themeluar një sistem të monitorimit të rezultateve të komunikuar të angazhimeve, për tu siguruar se rekomandimet janë zbatuar në mënyrë efektive.</p> <p>NJAB nuk kishte themeluar një sistem të monitorimit të rezultateve të komunikuar të angazhimeve, për tu siguruar se rekomandimet janë zbatuar në mënyrë efektive.</p> <p>Veprimi i kërkuar Bordi Drejtorëve nëpërmjet Komitetit të Auditimit të sigurojë që Njësia e Auditimit të Brendshëm në baza periodike monitoron rezultatet e komunikuar të angazhimit, për tu siguruar se rekomandimet janë zbatuar në mënyrë efektive apo që menaxhmenti i ndërmarrjes ka pranuar rrezikun e mos marrjes së veprimeve. Rezultati Njësia e Auditimit të Brendshëm me 29.01.2020 kishte hartuar raportin për rishikimin e të gjitha rekomandimeve të dhëna.</p>		Mentor Balaj Hekuran Nikçi Naki Sahiti	NJAB do të marrë veprimet e nevojshme në mënyrë që të bëjë monitorimin e implementimit të rekomandimeve nga NJAB.	Bordi i Drejtorëve Kryesuesi i Bordit	E Mbyllur	
38	Marrja e linjës kreditore pa aprovim të Bordit Drejtues	Gjetja: Në matricën e aprovimeve që specifikon ndarjen e kompetencave në mes BD dhe Menaxhmentit, në pikën C3 specifikohet se huatë mund të lejohen pas aprovimit final nga Bordi Drejtues. Bazuar në konfirmimet zyrtare të bankave kemi kuptuar se kompania ka të lejuar një linjë kreditore në vlerë prej 5,000€ për periudhën 17.05.2019 – 31.05.2024 e cila gjatë vitit 2019 nuk është shfrytëzuar. Megjithatë, Kompania nuk ka arritur të na sigurojë dëshmi të aprovimit nga Bordi Drejtues, si organ kompetent për aprovimin e huave.	<p>Veprimi i kërkuar Bordi Drejtorëve të sigurojë aprovimin për lejimin e linjës kreditore apo anulimin e saj.</p> <p>Bordi Drejtorëve me datë 24.07.2020 kishte aprovuar kërkesën e menaxhmentit për mbylljen e linjës kreditore. Pas kërkesës nga Kompania drejtuar bankës me datë 28.07.2020 banka kishte mbyllur linjën kreditore.</p>	Bordi i Drejtorëve	Kompania ka marrë veprimet e nevojshme dhe një gjë e tillë është e mbyllur.	Bordi i Drejtorëve Kryesuesi i Bordit	E mbyllur	

